



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit

P- 002

Prishtinë, më 8 dhjetor 2014

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 E 9 DHJETOR 2014**

Seancën e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 104 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të grupit prej 42 deputetëve.

Ai e përshëndeti ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Tracy Ann Jacobson, znj. Ulrike Lunaqek, nënkryetare e Parlamentit Evropian, komandantin KFOR-it, ambasadorët dhe përfaqësuesit të zyrave diplomatike në Kosovë, përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të ftuarit tjerë të pranishëm në këtë seancë të jashtëzakonshme.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

* * *

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryetari e njoftoi Kuvendin se Presidentja e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ia ka propozuar Kuvendit kandidatin për kryeministër të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa.

Kryetari i Kuvendit e ftoi kryetarin e PDK-së, z. Hashim Thaçi, që në emër të koalicionit qeverisës ta paraqesë arsyeshmërinë e propozimit.

Hashim Thaçi e paraqiti dhe e arsyetoi para Kuvendit propozimin që z. Isa Mustafa ta udhëheqë Qeverinë e Republikës së Kosovës, në mandatin e ardhshëm qeverisës.

Fjala e z. Hashim Thaçi është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari më pas e ftoi kandidatin e nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë ekspozenë mbi programin qeverisës të Qeverisë së re.

Isa Mustafa fillimisht e falënderoi presidenten e Republikës së Kosovës, z. Atifete Jahjaga, deputetët, ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Jacobson, përfaqësuesin e BE-së në Kosovë, korin diplomatik dhe të pranishmit në sallë.

Në katër vjetët e ardhshme Kosova do të qeveriset nga koalicioni qeverisës i dy partive më të mëdha në vend, së bashku me komunitetet joshumicë. Ne e kemi përgatitur Programin qeverisës, të cilin do ta aprovojë Qeveria që sot do ta zgjidhni dhe po të njëjtin do t'ua prezantojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Koalicioni qeverisës është ndërtuar duke pasur parasysh dhe duke e respektuar vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të shprehur me votë të lirë, si dhe detyrimin kushtetues për themelimin e institucioneve legjitime të vendit, funksionale dhe gjithëpërfshirëse.

Koalicioni zotohet të punojë shumë për forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit, për shtetin e së drejtës, dhe trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës përpara ligjit.

Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për domosdonë që të punojë shumë për zhvillimin ekonomik dhe për rritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë dhe mbi këtë bazë do të fokusohet në forcimin e sektorit privat, tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe krijimin e sa më shumë vendeve të reja të punës. Vetëm nëpërmjet forcimit të ekonomisë së tregut, e të bazuar në sundimin e rendit dhe të ligjit, institucionet dhe shoqëria jonë do të arrijnë zhvillim të mirëfilltë ekonomik dhe social.

Qeveria e Republikës së Kosovës përherë merr në konsideratë vizionin dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës për t'i përqafuar dhe për t'i mbrojtur vlerat më të mira civilizuese perëndimore, synimin për t'i përmbushur të gjitha standardet dhe reformat e domosdoshme për anëtarësimin e Kosovës në BE, OKB, NATO, OSBE dhe organizata të tjera ndërkombëtare, si dhe për ruajtjen dhe kultivimin e marrëdhënieve speciale me SHBA-të.

Programi qeverisës i Qeverisë së Republikës së Kosovës përqendrohet në këto shtylla kryesore: (I) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia; (II) Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;

(III) Agjenda evropiane dhe politika e jashtme; (IV) Arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor; dhe (V) Shëndetësia moderne.

Në vazhdim, z. Isa Mustafa i shtjelloi veç e veç të gjitha shtyllat e programit qeverisës, të cilat do të realizohen për katër vjetët e ardhshme.

Fjala e z. Isa Mustafa është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin lidhur me ekspozenë e z. Isa Mustafa.

Në vazhdim për fjalë u paraqitën deputetët: Adem Grabovci, në emër të GP PDK; Ismet Beqiri, në emër të GP LDK; Glauk Konjufca, në emër të GP VV; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të GP AAK; Jakup Krasniqi, emër të GP NISMA; Mahir Yagcilar, në emër të GP “6+”, si dhe Ramush Haradinaj, Ilir Deda, Pal Lekaj, Visar Ymeri, Melihate Tërmkolli, Shqipe Pantina, Fatmir Limaj, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Rexhep Selimi, Emilija Rexhepi, Puhie Demaku, Rustem Berisha, Mytaher Haskuka, Ismajl Kurteshi, Bekim Bislimi, Daut Haradinaj, Veton Berisha, Bali Muharremaj, Albin Kurti dhe Hashim Thaçi, fjala e të cilëve është dhënë në transkript.

Më pas, Adem Grabovci, në emër të GP PDK, e kërkoi një pauzë.

Me pëlqim të Kuvendit, kryetari e caktoi një pauzë prej 30 minutash.

Pas pauzës, Adem Grabovci, në emër të GP PDK, tha se pas konsultimeve edhe me partnerët e koalicionit qeverisës propozojnë shtyrjen e seancës për ditën e nesërme, më 9 dhjetor, në orën 12:00.

Lidhur me këtë propozim, në emër të grupeve parlamentar u deklaruan edhe deputetët: Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Zafir Berisha, fjala e të cilëve është dhënë në transkript.

Kryetari më pas kërkoi nga deputetët që të deklarohen nëpërmjet një votimi formal lidhur me kërkesën e deputetit Adem Grabovci.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi kërkesën e deputetit Adem Grabovci.

Kryetari konstatoi se vazhdimi i seancës do të bëhet më 9 dhjetor , në orën 12:00.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e jashtëzakonshme në orën 21:24 minuta.

* * *

9 dhjetor 2014, ora 12:00

Vazhdimi i seancës, e filluar më 8 dhjetor 2014

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të seancës së jashtëzakonshme, të filluar më 8 dhjetor 2014.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 113 deputetë.

Ai procedoi me pikën, si në vijim:

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryetari konstatoi se në seancën e filluar më 8 dhjetor 2014, i nominuari për kryeministër të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, e ka paraqitur para deputetëve të Kuvendit ekspozenë lidhur me Programin qeverisës dhe se diskutimet lidhur me këtë çështje kanë përfunduar në seancën e djeshme.

Më pas, ai e ftoi kandidatin e nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë përbërjen e Kabinetit qeveritar.

Isa Mustafa e paraqiti para Kuvendit përbërjen e Kabinetit qeveritar.

Fjala e z. Isa Mustafa është dhënë e plotë në transkript.

Në vazhdim, kryetari kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për zgjedhjen e Kabinetit qeveritar të Republikës së Kosovës, të paraqitur nga i nominuari për kryeministër, Isa Mustafa.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 73,
Kundër ----- 38,
Abstenim ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e kryeministrit, të zëvendëskryeministrave dhe të ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës

I. Zgjidhet Qeveria e Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:

1. Isa Mustafa, kryeministër i Republikës së Kosovës,
2. Hashim Thaçi, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Jashtëm,
3. Kujtim Shala, zëvendëskryeministër dhe ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
4. Branimir Stojanović, zëvendëskryeministër,
5. Haki Demolli, ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës,
6. Skender Hyseni, ministër i Punëve të Brendshme,
7. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë,
8. Arsim Bajrami, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
9. Abdullah Hoti, ministër i Financave,
10. Bekim Çollaku, ministër i Integritetit Evropian,
11. Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik,
12. Lutfi Zharku, ministër i Infrastrukturës,
13. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë,
14. Mahir Yagcılar, ministër i Administratës Publike,
15. Lubomir Mariq, ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal,
16. Memli Krasniqi, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

17. Ferid Agani, ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor,
18. Imet Rrahmani, ministër i Shëndetësisë,
19. Arban Abrashi, ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale,
20. Aleksandar Jablanoviq, ministër për Komunitete dhe Kthim,
21. Valon Murati, ministër i Diasporës,
22. Edita Tahiri, ministre pa portofol,
23. Rasim Demiri, ministër pa portofol.

* * *

Kryetari, më tej e ftoi kryeministrin dhe përbërjen e Kabinetit qeveritar që t'i zënë ulëset e tyre në Kuvend, ta bëjnë betimin dhe ta nënshkruajnë tekstin e betimit, gjë të cilën ata e bënë këtë.

Në fund të seancës, në emër të Qeverisë së zgjedhur, një fjalë të shkurtër rasti mbajti kryeministri Isa Mustafa.

Fjala e Isa Mustafës është dhënë e plotë në transkript.

* * *

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e jashtëzakonshme në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri Veseli

Përgatiti:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale